

## 1.9. PROFESIONI I KONTABILITETIT DHE ETIKA PROFESIONALE

Në kuadër të funksionimit normal të subjektit ekonomik, kontabiliteti ka rol dhe rëndësi të veçantë që rrjedh nga fakti se kontabiliteti paraqet sistem për identifikim, matje, analizim dhe përcjellja e informatave gjer tek shfrytëzuesit e atyre informative që ju ndihmon në sjelljen e vendimeve racionale dhe efikase afariste.

Në kuadër të kontabilitetit, si profesion i cila ka një fushë të gjerë të veprimit, veçanërisht potencohet kontabiliteti në sektorin komercial dhe kontabiliteti në sektorin publik. Gjithashtu, është karakteristike të theksohet se bëhen përpjekje për arritjen e nivelit sa më të lartë në edukimin e kontabilistëve dhe sjelljen etike të tyre, që njëherit ka rëndësi të madhe edhe në rritjen e kualitetit dhe besueshmërisë të profesionit të kontabilitetit.

### 1.9.1. Profesion i kontabilitetit

Kontabilistët luajnë role të ndryshme në shoqëri. Kuptimi i roleve të ndryshme të kontabilistëve do të ndihmojë në respektimin e plotë dhe në rëndësinë e kontabilitetit në subjektin ekonomik.

**Kontabilistët e punësuar në biznese private.** Shumë kontabilistë janë të punësuar në biznes firma në të cilat njëherit kryejnë funksione të rëndësishme për to. Informatat kontabël formojnë sistem që përbëhet nga raportet, përgjegjësia dhe kontrolli, që së bashku janë të njohura si kontabiliteti menaxherial. Pastaj ky grup i kontabilistëve merret me kontabilitetin financiar, kontabilitetin e shpenzimeve apo edhe me kontrollin e brendshëm.

**Kontabilistët të punësuar në biznese joprofitabile.** Organizatat jofitimprurëse si shkollat, spitalet, universitetet, qeveria etj. kanë nevojë për kontabilistë. Edhe pse fitimi nuk është qëllimi kryesor, të gjitha organizatat që të punojnë më mënyrë efikase detyrimisht duhet të kenë informata financiare. Evidentimi dhe kontrollimi i shpenzimeve nëpër të gjitha këto organizata është tepër e rëndësishme. Kontabilistët që punojnë tek bizneset jofitimprurëse, kryesisht kryejnë detyra të njëjta.

**Kontabilistët e punësuar në firmat publike të kontabilitetit.** Këto firma sigurojnë shërbime të çmueshme për shfrytëzuesit e tyre. Ato sigurojnë shërbime profesionale për klientët e tyre në këmbim të pagesës, si shpërblim për shërbimin. Këtu kyçen revizioni, tatimet dhe shërbimet për menaxhment konsultime.

Kontabilistët publik sigurojnë edhe shërbime në lidhje me tatimet. Këto, me kërkesë të firmave, kryejnë planifikimin dhe përlllogaritjen e tatimeve. Objektiviteti në përcaktimin e bazës për tatimim dhe saktësia në përlllogaritjen e shumës së tatimeve janë garanci për punë të suksesshme të firmës dhe për pagesën në kohë të detyrimeve ndaj shtetit. Kjo, gjithsesi, ka efekte pozitive edhe për sjelljen e vendimeve të ndryshme financiare në lidhje me shpërndarjen e rregullt të fitimit pas tatimit.

### **1.9.2. Kontabiliteti dhe etika**

Duhet të theksohet se qëllimi themelor i kontabilitetit është: të sigurojë informata të shfrytëzueshme dhe të dobishme të cilat ndihmojnë në procesin e vendimmarrjes. Liria e kontabilistëve dhe respekti ndaj tyre është njëra nga shkaqet kryesore që kontabiliteti të konsiderohet si profesion, ndërsa anëtarët e saj të llogariten si profesionist.

Për të qenë të shfrytëzueshme, informatat e kontabilitetit, duhet të jenë objektive dhe të besueshme. Menaxhmenti duhet të jetë përherë nën presion për të raportuar rezultatet e dëshiruara dhe të mos injorojë rregullat ekzistuese.

**Etika është shkencë mbi moralin; Etika parasëgjithash i përket filozofisë, e cila i studion sjelljet e njerëzve të cilat mbështeten në aspekte të ndryshme morale.**

Praktikat e kontabilitetit etik ndërtojnë raporte të besueshme, produktive dhe të sinqerta me shfrytëzuesit e informatave kontabël. Shumë kompani dhe organizata profesionale, kanë shkruar kodin e etikës i cili u shërben kontabilistëve si udhërrëfyes.

Aplikimin e etikës së kontabilitetit në praktikë, nuk duhet të presim që ta rregullojnë të tjerët por atë parimisht duhet ta bëjmë vetë. Ne më së miri e dimë se çka na duhet neve dhe çka iu duhet të tjerëve, apo çka presin të tjerët prej nesh.


Kontabilistëve, në nivel botëror, u kushtohet vëmendje e madhe. Kjo për faktin se këta persona punojnë në një problematikë shumë specifike dhe të rëndësishme. Këta përveç edukimit

nëpër shkolla profesionale, universitete kanë kaluar edhe nëpër shume kurse teorike, teknike dhe praktike të kontabilitetit si dhe kanë publikuar shumë punime nga kërkimet e bëra. Në edukimin e kontabilistëve kanë kontribuar edhe shumë institucione të ndryshme, asociacione, shoqata etj. Çdo ditë e më shumë etikës në kontabilitet i kushtohet një interes dhe kujdes i veçantë. Respektimi i paanshmërisë, sjelljes profesionale, pavarësisë, objektivitetit, ruajtjes së sekretit afarist etj. e rrisin besimin e vendimmarrësve ndaj pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare duhet të jenë në shërbim të përgjithshëm, të jenë të paanshme dhe nuk duhet ti shërbejnë interesave të veçanta.

#### 1.10. BAZAT E KONTABILITETIT TË DYFISHTË

Gjatë çdo këmbimi, të brendshëm apo të jashtëm, mjetet, burimet e mjeteve si dhe pasuria e subjektit ekonomik ndryshon dhe ky ndryshim duhet evidentuar me qëllim përcaktimin e rezultatit të sajë. Çdo ndryshim në mjete, burime të mjeteve, në të ardhurat dhe të dalat krijojnë efekte të ndryshme në rezultatin financiar.

Me zhvillimin e deritanishëm të kontabilitetit si sistem i evidentimit, në procesin e zhvillimit të teorisë dhe praktikës kontabël, varësisht nga mënyra e përgjithshme e evidentimit, nga qëllimi që dëshirojmë të arrijmë, si dhe llojit të librave afariste që i mbajmë janë të njohura



këto lloje të sistemeve kontabël:

Përveç këtyre dy varianteve themelore janë zhvilluar edhe variante të veçanta:

- **kontabiliteti kameral**, si variant e kontabilitetit të njëfishtë dhe
- **kontabiliteti konstant**, si variant e kontabilitetit të dyfishtë.

Karakteristikë themelore e kontabilitetit të njëfishtë është evidentimi i izoluar i ndryshimeve (ndryshimi i gjendjes të pjesëve të veçanta të pronës, ose detyrimet tregohen në libra të veçanta apo të ndara, të cilat nuk janë të lidhura në mes veti reciprokisht). Evidenton

vetëm detyrimet gjatë furnizimit të pasurisë, ndërsa kapitalin vetanak të deponuar në ndërmarrje nuk e evidenton. **Kontabiliteti i njëfishtë nuk mban llogari mbi pasurinë e tërësishme dhe nuk i pasqyron të ardhurat dhe të dalurat që e kanë zmadhuar ose zvogëluar kapitalin e pronarit.** Librat që përdoren në kontabilitetin e njëfishtë janë: libri i arkës, ku evidentohen të gjitha arkëtimet dhe pagesat nga arka, pastaj libri i kreditorëve dhe furnitorëve si dhe ditari, ku në mënyrë kronologjike evidentohen ndryshimet dhe pastaj barten në librin e arkës ose të debitorëve dhe kreditorëve.

Marrëdhëniet pronëso-ro-juridike me blerësit dhe furnitorët evidentohen ashtu që për secilin nga to hapet nga një fletë në librin e debitorit apo kreditorit. Rezultati afarist sipas këtij kontabiliteti nuk mundet të llogaritet drejtpërsëdrejti, për shkak se nuk mbahet evidencë mbi ndryshimet e të ardhurave dhe të dalave, por rezultati financiar përcaktohet në bazë të pasurisë neto.

**Kontabiliteti kameral** bazohet në kontabilitetin e njëfishtë, ndërsa është zhvilluar gjatë shek. XVII, për nevojat e ndjekjes së të ardhurave dhe të dalave shtetërore. Është përdorur tek institucionet publike-juridike tek të cilat afarizmi është kryer sipas buxhetit, andaj edhe quhet kontabiliteti buxhetor. *Vetia kryesore e kontabiliteti kameral është se së bashku me evidentimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të bëra evidentohet edhe plani i realizuar i të gjitha pozicioneve të shpenzimeve dhe të hyrave. Nëpërmjet krahasimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të realizuara me ato të planifikuara përcakton tepriçën apo mangësinë në planifikim.* Në kontabilitetin kameral ose buxhetor mbahen: libri i arkës dhe libri kryesor.

**Kontabiliteti konstant** bazohet në parimet e kontabilitetit të dyfishtë dhe është zhvilluar në Zvicër, gjatë shekullit XIX.. Në kuadër të kësaj evidence mbahet evidenca e tërësishme e të gjitha pasurive, shpenzimeve dhe të ardhurave. Që të sigurohet krahasimi në mes të ardhurave dhe të dalave të planifikuara me ato të realizuara, llogaritë apo kontot në librin kryesorë përbëhen nga tri grupe: kontove administrative, kontove të arkës dhe kontove për llogaritje.


**Kontabiliteti i dyfishtë është paraqitur gjatë zhvillimit të hovshëm të tregtisë dhe marrëdhënieve kredituese në Itali, gjatë shek. XV dhe XVI. Kontabiliteti i dyfishtë paraqet një sistem të plotë, i tërësishëm, i mbyllët i evidencës.**

**Në kontabilitetin e dyfishtë** - mbahet evidencë adekuate kontabël për të gjitha mjetet dhe burimet e mjeteve, për të dalat dhe të ardhurat. Në bazë të një evidence të tillë të tërësishme, sipas një metodologjie të caktuar, përcaktohet rezultati financiar. Në kontabilitetin e dyfishtë mbahen këto libra afarist: ditari, libri kryesor dhe librat ndihmëse.

Emri kontabilitet i dyfishtë rrjedh nga fakti se çdo transaksion (ndryshim) kontabël që shkakton ndryshime vlerore në mjete, në burime, në të hyra, në të dala etj. detyrimisht duhet të evidentohen së paku në dy llogari, anë të kundërta (në anën pozitive dhe negative; në debi dhe në kredi; në anën e majtë dhe të djathtë) edhe atë me një barazi vlerore. Me këtë është siguruar përfshirja e tërësishme dhe ndjekja e lëvizjes së mjeteve, kapitalit dhe detyrimeve, si dhe baraspesha e tyre. Këtu duhet theksuar se me kontabilitetin e dyfishtë mundësohet përfshirja e tërësishme e evidentimit të veprimtarisë afariste të subjektit ekonomik, evidentimi i dyanshëm i ndërrimeve kontabël dhe evidentimi permanent dhe sistematik i ndërrimeve kontabël.

#### **1.10.1. Sistemi i regjistrimit të dyfishtë**

Sistemi i regjistrimit të dyfishtë sot pothuajse është metodë e vetme e regjistrimit në kontabilitet dhe bazohet në parimin e dualitetit. Kjo përmban metodën bazë të regjistrimit të ndryshimeve që ndodhin në subjektin ekonomik. Ky sistem për nga rëndësia që ka pasur për njerëzimin, është vlerësuar si një nga zbulimet më të shkëlqyera të intelektit njerëzor. Parimet kryesore të sistemit të dyfishtë janë:



Metoda e regjistrimit të dyfishtë e ka burimin në parimin e dualitetit që në mënyrë figurative shprehet në dy pole: Poli i nisjes që shpreh origjinën e veprimit ekonomik (burimet + elementi që jep) dhe poli i mbëritjes që shpreh destinacionin e veprimit ekonomik (përdorimi = elementi që mer. Sipas kësaj metode cdo veprim ekonomik prek, të paktën, dy llogari në të cilat shkaktohen efekte të kundërta, njera debiton e tjetra krediton për të njejtën shumë, në të njejtën kohë duke mos ndryshuar ekuacionin kontabël.<sup>1</sup> Për ta pasqyruar kontabilitetin e dyfishtë ekziston thenja “ai që merr duhet të jep dhe ai që jep duhet të merr”. Ai që merr apo pranon në kontabilitet quhet Debitor dhe ai që jep quhet Kreditor.

Gjatë evidentimit në kontabilitetin e dyfishtë çdo ndryshim kontohet njëkohësisht me vlera të njëjta në dy anët e kundërta të dy apo më shumë kontove. Pra, kontabiliteti i dyfishtë është sistem evidence, i cili për shënime i shfrytëzon kontot e dyanshme dhe tek i cili çdo ndryshim (transaksion) tregohet apo shënohet në vlera të njëjta në anën debi të njërës konto dhe në anën kredi të kontos tjetër. Po qe se përdoren më tepër konto, edhe në atë rast vlen rregulla e njejtë  $Debi = Kredi$ , një apo më tepër konto të debisë = me një apo më tepër konto të kredisë. Në kontabilitetin e dyfishtë evidentohet pasuria e tërësishme e sipërmarrësit, të gjitha kapitalet, të hyrat dhe të dalurat e tërësishme si dhe rezultati financiar afarist.

<sup>1</sup> Abim Binaj, Flutra Kalemi, Kontabiliteti-koncepte, metoda dhe përdorime, Tiranë 2008, faq.106.

## Pyetje

1. Si e përkufizon prof. Sotiraq Dhamo, kontabilitetin?
2. Numëro disa konkluzione që mund të nxjerrim nga definicionet mbi kontabilitetin?
3. Cilat kushte duhet ti plotësojnë veprimtaritë ekonomike që të jenë objekt i regjistrimit në kontabilitet?
4. Sqaro mbi gjurmët e kontabilitetit në lashtësi!
5. Libri i cilit autor konsiderohet si themelues i kontabilitetit të dyfishtë?
6. Përdoruesit e informacionit kontabël grupohen në: a) \_\_\_\_\_ dhe b) \_\_\_\_\_
7. Numëroi përdoruesit e të dy grupeve të informacioneve kontabël?
8. Cilët janë parimet e etikës profesionale të kontabilistit?
9. Çka është lënda e evidencës kontabël?
10. Cilat janë detyrat e evidencës kontabël?
- 11.. Cili është roli i evidencës kontabël?
12. Cilët janë rregullat më kryesore të kontabilitetit?
13. Cilët janë parimet themelore të kontabilitetit?
14. Numëroi llojet e sistemeve kontabël?
15. Numëro disa nga parimet themelore të kontabilitetit të dyfishtë?
16. Cilat janë format kryesore të organizimit të biznesit?

### USHTRIMI Nr.1

Përcaktoni se në cilin grup të përdoruesve të informacionit përfshihen përdoruesit në vijim:

Përdoruesi	I brencëm- Intern	I jashtëm –ekstern
<b>Furnitorët</b>		+
Aksionarët e njësisë		
Sindikata e punonjësve		
Punëtori i Bankës		
Përgjegjësi i shitjes		
Avokati		
Anëtari i bordit drejtues		
Punonjësit e drejtorisë tatimore		
Audituesit e jashtëm		
Përfaqësuesit e shtypit		
Punonjësit e marketingut të njësis ekonomike		
Drejtorja e planifikimit makroekonomik		
Përgjegjësi i repartit të prodhimit		
Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit		

## Ushtrime

1. Identifikoni përshkrimet e poshtshënuara se cilave rregulla kontabël u takojnë?

- Verifikimi i saktësisë së çdo dokumenti në çdo moment. \_\_\_\_\_ K

- Kërkimi i një dokumenti (p.sh. faturës dalëse) duhet të jetë i shpejtë, i lehtë dhe i kuptueshëm.  
\_\_\_\_\_ P

- Formimi dhe regjistrimi në kohë i dokumenteve brenda 8 ditëve nga kur kanë ndodhur.  
\_\_\_\_\_ A

- Regjistrimi apo evidentimi në kontabilitet bëhet në bazë të dokumenteve të caktuara dhe të verifikuara. \_\_\_\_\_ D

- Regjistrimi i të gjitha ndryshimeve të ndodhura në subjektin ekonomik.  
\_\_\_\_\_ Pl

- Regjistrimi i ndryshimeve kontabël sipas datës së ndodhur. \_\_\_\_\_ Kr

- Regjistrimi se në cilën faqe të ditarit është regjistruar, si dhe ku është bartur, në cilën konto analitike dhe sintetike. \_\_\_\_\_ Li

- Korrigjimi apo përmirësimi i gabimit të bërë duhet të mundëson leximin e asaj që është fshirë  
(25.000) 52.000 \_\_\_\_\_ Pe